



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E RROGOZHINË

Rrogozhinë me ____/____/2024

**SHALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE
PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE
(SPECIALIST)**

Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike/Juridike”

Titulli minimal i diplomës “Master Profesional”

Në zbatim të nenit 22 dhe 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të VKM nr. 243, datë 18/03/2015, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Rrogozhinë, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimi në Shërbimin Civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

- **2 (dy) Specialistë Auditë në Sektorin e Auditit të Brendshëm, Bashkia Rrogozhinë, kategoria e pagës IV-a.**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë)
aplikohet në të njëjtën kohë!**

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE:	21.6.2024
Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL:	28.6.2024



1. Kryerja e veprimtarive të auditimit të brendshëm sipas udhëzimeve e metodave të miratuara nga NJAB.
2. Të njohin, të respektojnë dhe të ushtrojnë veprimtarine në përputhje me aktet ligjore e nenligjore në fuqi dhe me standartet e auditimit të brendshëm në sektorin publik.
3. Të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, sipas normave dhe procedurave të vecanta të veprimtarisë së auditimit të brendshëm.
4. Të veprojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kodin e etikës dhe rregullat për konfidencialitetin për audituesin, i cili miratohet nga Ministri i Financave dhe nënshkruhet nga secili auditues.
5. Të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur nga pikepamja profesionale, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit.
6. Kërkon dhe kontrollon zbatimin e përfundimeve të auditimit nga subjektet e audituara, në afatet e kërkuara nga aktet ligjore.
7. Të propozojnë drejtuesit të njesisë së auditimit dhe, nëpërmjet tij drejtuesit të subjektit, pezullimin deri në shqyrtimin nga organi përkatës të veprimeve të kundraligjshme, të cilat demtojnë rëndësi të interesit të subjektit dhe/ose janë të arsyetuara e përbejnë vepra penale.
8. Të japin rekomandime subjektit të audituar për ndreqjen e parregullsive, për masat që duhen ndërmarrë në rastet e detyrës ekonomike dhe financiare për çdëmtimin e tyre, si dhe të bëjnë propozime, të cilat synojnë të ulin mundësinë e perseritjes së këtyre rasteve në të ardhmen.
9. Të mos bëjnë publike asnjë të dhënë, fakt apo rast të gjetur gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajnë dokumentat për çdo veprimtari auditimi të kryer, bazuar në detyrimet.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë bachelor, “Master Profesional” ose Shkencor në ekonomik, finance, kontabilitet/drejtësi. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *(Diplomat*



të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

b- Të ketë 3 vite eksperiencë pune në profesion.

c- Njohja e gjuhës së huaj anglisht ose ndonjë gjuhë tjetër përbën avantazh.

d- Mbajtësi i këtij pozicioni duhet të ketë aftësi të mira komunikimi.

e- Njohje të programeve bazë kompjuterike.

- U jepet përparësi në përzgjedhje, kandidatëve të certifikuar “kontabilistë të miratuar”

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë ose dorazi në Bashkinë Rrogozhinë, dokumentat si më poshtë:

a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);

c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet me postë ose dorazi në Sektorin e Burimeve Njerëzore brenda datës **21.06.2024 në Bashkinë Rrogozhinë.**

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **24.6.2024**, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Rrogozhinë do të



shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Ligjin Për auditimin e brendshëm në sektorin public
2. Kodit të Etikës dhe Kartës së Auditimit të Brendshëm Publik
3. Ligji 10256 datë 8.7.2010 “Menaxhimi Financiar dhe kontrolli”(I ndryshuar);
4. . Ligji 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore:“ ;
5. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
6. Udhëzim i MF Nr. 17, datë 25.7.2011 për “Përmbushjen e inspektimit financiar publik dhe kontrollin e cilësisë”.
7. Udhëzimi i MF nr. 12, datë 05.06.2012 mbi “Procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”
8. Ligjin për Nëpunësin Civil,

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë, i ndarë në:

- 20 pikë përvojë.
- 10 pikë për trainime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse.



- 10 pikë për çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet individuale në punë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-datë-27-03-2015>.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Rrogozhinë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në stendën e informimit publik të Bashkisë Rrogozhinë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga NJBNJ, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2

PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kriteret e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin



civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojë diplomë bachelor, “Master Profesional” ose Skencor në Financë, ekonomik, kontabilitet/ drejtesi. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.
(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
 - b- Të ketë **1 vit** eksperiencë pune në profesion.
 - c- Njohja e gjuhës së huaj anglisht ose ndonjë gjuhë tjetër përbën avantazh.
 - d- Mbajtësi i këtij pozicioni duhet të ketë aftësi të mira komunikimi.
 - e- Njohje të programeve bazë kompjuterike.
- U jepet përparësi në përzgjedhje, kandidatëve të çertifikuar “kontablistë të miratuar”**

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);



- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet me postë ose dorazi në Sektorin e Burimeve Njerëzore brenda datës **28.6.2024 në Bashkinë Rrogozhinë.**

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **5.7.2024**, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Rrogozhinë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Rrogozhine për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

1. Ligjin Për auditimin e brendshëm në sektorin public
2. Kodit të Etikës dhe Kartës së Auditimit të Brendshëm Publik
3. Ligji 10256 datë 8.7.2010 “Menaxhimi Financiar dhe kontrolli”(I ndryshuar);
4. Ligji 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore:“ ;



5. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
6. Udhëzim i MF Nr. 17, datë 25.7.2011 për “Përmbushjen e inspektimit financiar publik dhe kontrollin e cilësisë”.
7. Udhëzimi i MF nr. 12, datë 05.06.2012 mbi “Procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”
8. Ligjin për Nëpunësin Civil,

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”
<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Rrogozhinë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet



adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimi në shërbim civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e Bashkisë Rrogozhinë për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimi në shërbim civil për kategorinë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,*
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;*

Shpallur sot më date 10.6.2024